


STATUTI I UNIVERSITETIT AAB





PËRMBAJTJA

1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	3
2. STRUKTURA ORGANIZATIVE.....	5
1. Njësitë akademike.....	5
2. Njësitë organizative	9
3. ORGANET DREJTUESE TË UNIVERSITETIT AAB	10
Bordi i Universitetit	10
Senati.....	12
Rektori i Universitetit	13
Prorektorët.....	15
Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit.....	16
4. STAFI AKADEMIK DHE JOAKADEMIK	17
5. STUDENTËT DHE ORGANIZIMI I STUDIMEVE.....	19
6. TITUJT AKADEMIK DHE DIPLOMAT	25
7. FINANCIMI	27
8. DISPOZITAT KALIMTARE.....	28

Senati i Universitetit AAB (Arena e Arsimit Bashkëkohor), në mbledhjen e mbajtur me datën 25.09.2008 miratoi këtë statut.

1. DISPOZITAT E PËRGGJITHSHME

Neni 1

Universiteti AAB (në tekstin e mëtejme Universiteti) është institucion i arsimit të lartë, me karakter mësimor–shkencor. Ai është themeluar në pajtim me Ligjin mbi Arsimin e Lartë të Kosovës dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi, dhe është licencuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Numri i licencës është Nr. 1587/02-1

Qëllimi i tij është që:

- Të zhvillojë mësim dhe hulumtim shkencor;
- Të jetë i hapur për të gjithë mbi bazën e barazisë dhe të meritës pa diskriminim etnik;
- Të luajë rol udhëheqës në zhvillimin arsimor, shkencor, kulturor, social dhe ekonomik të Kosovës;
- Të zhvillojë programin e tij me orientim ndërkombëtar dhe evropian;
- Të ndihmojë procesin e ngritjes së demokracisë qytetare.

Neni 2

Statuti i Universitetit, në pajtim me Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë dhe dispozitat e tjera të kësaj fushe, rregullon misionin, organizimin, qeverisjen, mënyrën e zgjedhjes së organeve të Universitetit, zhvillimin e studimeve, statusin e personelit akademik, administrativ dhe të studimeve, çështjen e disiplinës institucionale, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për Universitetin.

Neni 3

Personeli dhe studentët e Universitetit kanë të drejtë të gëzojnë:

- Lirinë në fushën e shoqërimit dhe të shprehjes lidhur me strukturat e garantuara sipas këtij Statuti dhe rregulloreve të Universitetit;
- Të drejtën që të mos jenë të diskriminuar në mënyrë direkte ose indirekte sipas gjinisë, racës, orientimit seksual, statusit martesor, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike ose bindjeve të tjera, bashkëpunimit me komunitetin nacional, pronës, statusit të lindjes apo ndonjë statusi tjetër.

Neni 4

Sipas dispozitave të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Universiteti është person juridik me të gjitha të drejtat e tij përfshirë këtu edhe:

- Të drejtën të padisë dhe të jetë i paditur;
- Të drejtën e përdorimit të flamurit, vulës, stemës dhe emblemave të tjera;
- Me autorizimin e Bordit të ndalojë përdorimin e titullit të tij nga persona ose organizata të ndryshme;
- Të drejtën e ndalimit të paraqitjes së ndonjë fakulteti apo njësie tjetër të Universitetit si person juridik;
- Sipas këtij Statuti, fakultetet ose njësitë tjera të Universitetit do të kenë autorizime të kufizuara.

Neni 5

Në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë (Rregullorja nr.2003/14), Universiteti ka autonomi akademike në mësimdhënie universitare dhe komunikim publik. Fuqia e kësaj lirie akademike varet nga dispozitat e këtij Statuti, si vijon:

- Të planifikojë dhe të përcaktojë përmbajtjen dhe strukturën e programit akademik, shkencor, artistik dhe profesional në mësimdhënie universitare dhe punën kërkimore – shkencore;
- Të përcaktojë metodologjinë që e zbaton në procesin e mësimdhënies;
- Të zgjedhë zyrtarë akademikë;
- Të emërojë, të rregullojë çështjen e punësimit, si dhe të largojë nga puna profesorët, anëtarët e tjerë të stafit akademik dhe administrativ;
- Të pranojë studentë dhe të përcaktojë kushtet e pranimit të tyre;
- Të ndajë bursa për studentët e dalluar;
- Të japë shkallë dhe diploma si dhe të marrë shkallë dhe diploma nga persona të veçantë për ndonjë arsye të fortë;
- Të japë tituj shkencorë dhe grada nderi;
- Të rregullojë organizimin e brendshëm të Universitetit

1.1. Emri, selia dhe simbolet

Neni 6

Emri i Universitetit është Universitetit AAB (Arena e Arsimit Bashkëkohor).
Selia e Universitetit është: Zona Industriale Prishtinë, 10000 Prishtinë

Neni 7

- 1) Universiteti ka stemën, vulën, vulën e thatë.

- 2) Formën e stemës e përcakton Bordi me vendim të posaçëm.
- 3) Vula dhe vula e thatë kanë formën e rrumbullakët dhe në mes kanë stemën e Universitetit.

Neni 8

Universiteti ka përvjetorin e tij më 15 Maj, që është dita kur është mbajtur mbledhja e parë e themelimit të Universitetit në vitin 2002.

Neni 9

- 1) Të gjitha mjediset (ndërtimore dhe trojet) që janë nën administrim të Universitetit, si dhe çdo mjedis i fituar në të ardhmen në bazë të ligjit, janë të paprekshme. Kjo paprekshmëri nënkupton moslejimin e intervenimit në mjediset e Universitetit të çdo personi fizik e juridik (shtetëror ose privat), mosndërhyrjen e pushtetit dhe të organeve të rendit pa lejen apo kërkesën e Rektorit ose të personit të autorizuar prej tij.
- 2) Përgjashtim bëjnë rastet e ndonjë krimi të rëndë dhe rastet e fatkeqësisë natyrore.
- 3) Ndërhyrja e forcave të policisë mund të bëhet edhe pa lejen e Rektorit.
- 4) Për çdo cenim të paprekshmërisë, Universiteti ka të drejtën e denoncimit të shkeljes dhe të kërkimit të ndëshkimit të shkelësve sipas dispozitave ligjore.

2. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 10

Struktura organizative e Universitetit përbëhet nga:

1. Njësitë akademike dhe
2. Njësitë organizative

1. Njësitë akademike

Neni 11

a) Njësitë akademike të Universitetit janë:

1. Fakulteti i Komunikimeve Masive;
2. Fakulteti i Arteve Muzikore;
3. Fakulteti i Arteve Figurative dhe
4. Fakulteti i Arteve Aplikative;
 - i. Departamenti i Arkitekturës
 - ii. Departamenti i Enterierit
5. Fakulteti Ekonomik
 - i. Departamenti i Menaxhmentit dhe Informatikës

- ii. Departamenti Administrim Biznesit dhe Marketingut
 - iii. Departamenti Banka, Financa dhe Kontabilitetit
 6. Fakulteti Juridik
 - i. Departamenti i Përgjithshëm dhe
 - ii. Departamenti i Administratës Publike.
 - iii. Departamenti i Kriminalistikës
 7. Fakulteti Filozofik – Filologjik
 - i. Departamenti i Gjuhëve të Huaja
 1. Dega e Gjuhës Angleze
 8. Fakulteti i Kriminalistikës;
 9. Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit;
 10. Fakulteti i Edukimit dhe Mësuesisë.
- b) Në kuadër të njërive akademike funksionojnë departamentet.
- c) Në departamentin e Administratës Publike, funksionon dega e Diplomacisë, kurse departamenti i Kriminalistikës në kuadër të Fakultetit Juridik do të funksionojë vetëm në rastë të pamundësisë për të funksionuar si fakultet i veçantë.

Neni 12

Sipas dispozitave të këtij statuti që kanë të bëjnë me organizimin, njësitë akademike kanë status të njëjtë.

Njësia akademike ka emrin dhe vulën e vet. Njësia akademike mban emblemën dhe emrin e Universitetit brenda emblemës dhe emrit të saj.

Neni 13

Me propozim të Senatit të Universitetit dhe vendim të Bordit të Universitetit, drejtimet mund të shndërrohen në departamente – njësi akademike.

Neni 14

Varësisht prej madhësisë (numrit të personelit akademik, numrit të mjaftueshëm të profesorëve, sipas fushave akademike dhe përqindjes së personelit të përhershëm), fakultetet duhet t'i plotësojnë standardet ndërkombëtare sipas sistemit të Bolonjës në mënyrë që të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm dhe veprimtari profesionale në fushat përkatëse për një periudhë afatgjate.

Neni 15

Njësitë akademike janë përgjegjëse:

- Për çështjet akademike që kanë të bëjnë me lëndët që ligjërohen në departament dhe t'i propozojë Senatit të Universitetit sugjerimet e veta lidhur me këto;
- Të organizojë mësimdhënien, provimet dhe vlerësimin e studentëve;

- Të zhvillojë kërkime shkencore ose krijimtari artistike sipas standardeve ndërkombëtare;
- Për çështjen e personelit në bazë të dispozitave të këtij Statuti;
- Të përdor drejt dhe në mënyrë efikase mjetet, siç është paraparë me këtë Statut;
- Të sigurojë cilësinë, vlerësimin dhe çështjet e raportimit, siç është paraparë me këtë Statut.

Neni 16

Çdo fakultet udhëhiqet nga Dekani i tij, i zgjedhur me shumicën absolute të votave të anëtarëve të Senatit për një periudhë trevjeçare nga radhët e profesorëve të rregullt (prof.dr), profesorëve të asocuar ose profesorëve asistentë që ligjërojnë në fakultetin përkatës me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat me propozimin e fakultetit.

Kandidatët për postin e Dekanit të fakultetit duhet të posedojnë aftësi dhe përvojë në udhëheqje.

Neni 17

1. Mandati i Dekanit të fakultetit mund të përfundojë para kohe në rast të:
 - 1.1. Dorëheqjes;
 - 1.2. Shkarkimit;
 - 1.3. Arsyeve shëndetësore;
 - 1.4. Dënimit për vepra penale dhe
 - 1.5. Vdekjes.
2. Procedura për shkarkimin e Dekanit mund të iniciohet nga:
 - 2.1. Bordi;
 - 2.2. Senati;
 - 2.3. Rektori dhe
 - 2.4. 2/3 e anëtarëve të Këshillit shkencor mësikor.
3. Procedura për shkarkimin e Dekanit të fakultetit përcaktohet me aktin e nxjerrë nga Senati i Universitetit.

Neni 18

- 1) Dekani i fakultetit i përgjigjet Rektorit.
- 2) Detyrat e Dekanit janë:
 - 2.1 Të sigurojë udhëheqje akademike në fushat përkatëse për zhvillimin e mësimit, punës shkencore dhe artistike në fakultet;
 - 2.2 Të ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të caktuara nga Senati;

- 2.3 Të sigurojë informata të mjaftueshme në lidhje me sigurimin e mjeteve dhe rezultateve në mësim, në kërkime shkencore dhe artistike për Rektorin dhe Senatin sipas dispozitave të këtij Statuti;
- 2.4 Të përfaqësojë fakultetin në Senat;
- 2.5 T'i japë sugjerime Rektorit dhe Senatit për zgjedhjen e personelit akademik në lëndët e fakultetit;
- 2.6 T'i kryejë detyrat e tjera të përgjegjësisë të parapara me këtë Statut.

Neni 19

Në kuadër të organeve drejtuese të njësive akademike funksionojnë edhe Këshillat Shkencore Mësimore.

Neni 20

Këshilli Shkencor Mësimor (në tekstin e mëtejme Këshilli) përbëhet nga të gjithë profesorët e rregullt të angazhuar me kontratë të rregullt pune, asistentët, dekani dhe prodekanët.

Neni 21

Këshilli konstituohet çdo fillim viti akademik me rastin e angazhimit të mësimdhënësve dhe përcaktimit të statusit të tyre.

Neni 22

Kompetencat e Këshillit janë të karakterit vendimmarrës dhe këshillëdhënës.

Neni 23

Këshilli kryen punë nga fushat si vijon:

- Propozon kandidatët për Dekan të Fakultetit;
- Propozon kandidatët për Prodekanë të Fakultetit
- Brenda anëtarëve të Këshillit formon komisione profesionale (komisione për vlerësimin e studentëve, komisione për hartimin e raporteve-recensioneve për mësimdhënësit kandidat, komisione për vlerësimin e teksteve, komisione për hartimin e planeve të veprimit etj);
- I propozon Dekanit kandidatët për plotësim të personelit akademik;
- Formon këshilla apo grupe punuese të cilëve në bashkëpunim me organet e tjera drejtuese u jep detyra të caktuara;
- Emëron komisionin për vlerësimin dhe punimin e temës së masterit (magjistraturës) dhe të doktoraturës, si dhe për mbrojtjen publike të temës së masterit respektivisht të doktoraturës;
- Shqyrton raportin vjetor të Dekanit;

- Jep udhëzime fakultetit dhe organeve të tij për mënyrën e realizimit të plan programit mësimor;
- Kryen edhe punë të tjera në interes të njësisë akademike.

2. Njësitë organizative

Neni 24

Njësitë organizative funksionojnë në kuadër të Universitetit; ato ofrojnë shërbime mbështetëse për punë arsimore, kërkimore dhe artistike, si dhe shërbime administrative për njësitë akademike të Universitetit, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e përgjegjësisë dhe detyrave të Universitetit siç parashikohet me këtë Statut.

Neni 25

Në kuadër të Universitetit funksionojnë këto njësi organizative:

- Biblioteka e Universitetit;
- Qendra e rrjetit kompjuterik të Universitetit;
- Laboratori kriminalistik;
- Studio për pikturë;
- Studio e televizionit;
- Laboratori dhe studio për fotografi;
- Studio e Radios;
- Studio për piano;
- Studio për instrumentet muzikore;
- Studio për skulpturë;
- Studio për pikturat monumentale;
- Laboratori dhe studio për dizajn;
- Studio e fitnesit dhe
- Studio për përkthimin konsektiv dhe simultan

Në të ardhmen mund të themelohen edhe njësi të tjera organizative.

Neni 26

Njësia organizative udhëhiqet nga përgjegjësi i saj.

Neni 27

Përgjegjësi i njësisë organizative emërohet në bazë të konkursit publik dhe i përgjigjet Rektorit.

Neni 28

Përgjegjësi i njësisë organizative ka këto detyra:

- 1) Të sigurojë menaxhim efikas të njësisë organizative dhe përmbushjen e misioneve;
- 2) Të përkujdeset për shfrytëzimin efikas, ekonomik dhe efektiv të njësisë;
- 3) Të dorëzojë rregullisht raporte të mjaftueshme për Rektorin, Bordin dhe Senatin;
- 4) Të sugjerojë Rektorin dhe Senatin për emërimin e anëtarëve të personelit të njësisë;
- 5) Të kryejë detyra të tjera të përgjegjësit të parapara me këtë Statut.

3. ORGANET DREJTUESE TË UNIVERSITETIT AAB

Neni 29

Organet kryesore të Universitetit janë Bordi dhe Senati. Bordi mund të ushtrojë fuqinë e vet sipas këtij Statuti dhe të themelojë organe të tjera, si komitete dhe komisione me detyra specifike si dhe t'i suspendojë ato.

Të gjitha organet drejtuese të Universitetit ushtrojnë aktivitetin e tyre mbi parimin e votimit me shumicë votash përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Statut.

Neni 30

Rektori është drejtuesi akademik e administrativ dhe përgjegjës për Universitetin. Rektori i përgjigjet Bordit të Universitetit për punën akademike të Universitetit brenda obligimeve të tij.

Rektorin e ndihmojnë Prorektorët dhe Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit siç parashihet me këtë Statut.

BORDI I UNIVERSITETIT

Neni 31

- 1) Bordi i Universitetit (në tekstin e mëtejshëm "Bordi") është organi kryesor drejtues i Universiteti.
- 2) Bordi përbëhet prej 7 anëtarëve me të drejtë vote, dhe ata janë:
 - 2.1. 3 anëtarë të zgjedhur nga themeluesi i Universitetit;
 - 2.2. 2 anëtarë i zgjedhur nga Senati me të drejtë vote nga personeli akademik i Universitetit;
 - 2.3. Senati zgjedh edhe 1 anëtarë nga mes i komunitetit shkencor ndërkombëtarë;
 - 2.4. Themeluesi është anëtarë i përhershëm i bordit
- 3) Rektori dhe Sekretari i Përgjithshëm janë anëtarë ex-officio të Bordit pa të drejtë vote.
- 4) Kryetari i Parlamentit të Studentëve mund të marrë pjesë në mbledhjen e Bordit, pa të drejtë vote, kur trajtohen çështje që kanë të bëjnë me studentët.

Neni 32

- 1) Kryetari i Bordit zgjidhet me shumicë votash nga radha e anëtarëve të zgjedhur të Bordit. Kryetari ka zëvendës kryesuesin;
- 2) Mandati i anëtarëve të Bordit zgjat tre vjet me mundësi vazhdimi;
- 3) Për mbajtjen e mbledhjeve të Bordit nevojitet shumica absolute;
- 4) Vendimet Bordi i merr me shumicë votash (shumicën e të gjithë anëtarëve).

Neni 33

Në bazë të dispozitave të këtij Statuti dhe të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, Bordi është përgjegjës për:

1. Nxjerrjen e Rregullores për organizimin e brendshëm të njësive akademike me propozimin e fakulteteve përkatëse;
2. Miratimin e plotë të procesit edukativo – arsimor dhe të misionit të Universitetit, përfshirë këtu edhe programet e qendrave të hulumtimit dhe kërkimin, sipas propozimit të Senatit ose në raste të veçanta, të bëjë konsultime me ekspertë ndërkombëtarë dhe të mbikëqyrë aktivitetin e Universitetit;
3. Themelimin e procedurave për sigurimin e cilësisë akademike, duke përfshirë emërimin e komisionit për vlerësimin dhe miratimin e doracakut për vlerësim e punës;
4. Përdorimin efikas të burimeve, kapaciteteve të Universitetit dhe ruajtjen e pronës;
5. Të vendosë në lidhje me themelimin, shuarjen dhe ndryshimin e strukturës së brendshme të njësive akademike dhe njësive organizative pasi që të jetë konsultuar me Senatin, nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë Statut si dhe të vendosë për hapjen dhe shuarjen e njësive të veta nëpër qendrat e Kosovës sipas dinamikës së kërkuar;
6. Të vendosë për strukturën e përgjithshme organizative të njësive akademike, sipas propozimit të Senatit;
7. I propozon themeluesit të Universitetit plotësime, ndryshime të politikës financiare;
8. Të zgjedhë Rektoren dhe Prorektorët me propozimin e Senatit;
9. I propozon themeluesit të Universitetit për investime dhe blerjen e pajisjeve;
10. Njëherë në vit mund të kërkojë nga Shefi i shërbimit të financave që të informohet për raportet financiare, problemet e paraqitura dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre;
11. Të japë pëlqimin për pranimin e punëtorëve në vende të reja të punës;
12. Të nxjerrë Rregulloren e punës së Bordit;
13. Të vendosë për shpalljen e konkursit për pranimin e studentëve;
14. Të vendosë për shpalljen e konkursit për pranimin e personelit akademik;
15. Mund t'i propozojë themeluesit të Universitetit lartësinë e pagesës për regjistrimin dhe shkollimin e studentëve;
16. Të vendosë për ndarjen e bursave për studentët e dalluar;
17. Mund t'i propozojë themeluesit plotësim dhe ndryshime për koston e shërbimeve;
18. Të vendosë për shfrytëzimin e mjeteve në mënyrë të efektshme dhe të frytshme;
19. Mban evidencën e të punësuarve dhe inventarit të Universitetit;

20. Të nxjerrë Rregulloren për procedurën dhe masat disiplinore të Universitetit;
21. Të formojë komisione, në pajtim me Statutin e Universitetit, komisione të cilat do të merren me çështje të veçanta nga fushëveprimi i tij;
22. Të vendosë për formën dhe përmbajtjen e stemës, vulës, vulës së thatë, flamurit dhe simboleve të tjera;
23. Të kryejë edhe punë të tjera në pajtim me ligjin dhe me këtë Statut.

Neni 34

Procedurat për takimet e Bordit përgatiten nga Kryetari me këshillim të Sekretarit të Universitetit.

Neni 35

Bordi do të punojë në bazë të Rregullores së Bordit të përgatitur dhe të miratuar nga vetë Bordi.

SENATI

Neni 36

- 1) Senati i Universitetit është organi më i lartë profesional i Universitetit. Ai vendos për të gjitha çështjet e rëndësishme të Universitetit në fushën e mësimin, kërkimit shkencor dhe artistik.
- 2) Senati, si organi më i lartë akademik, përbëhet prej:
 - 2.1. Rektorit;
 - 2.2. Prorektorëve;
 - 2.3. Dekanëve të të gjitha njësive akademike;
 - 2.4. Një anëtar i zgjedhur nga stafi akademik i secilës njësi akademike;
 - 2.5. Një përfaqësuesi të studentëve;
 - 2.6. Një anëtar nga stafi teknik-administrativ.
- 3) Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit është anëtar i përhershëm i Senatit pa të drejtë vote.

Neni 37

Senatin e kryeson Rektorin. Në mungesë të Rektorit, Senatin e kryeson prorektori i caktuar nga Rektorin.

Neni 38

Në varësi të përgjegjësive të përgjithshme të Bordit dhe të përgjegjësive të Rektorit dhe Prorektorëve, Senati ka kompetencë për:

1. Çështjet e përgjithshme strategjike që lidhen me kërkime, studime, mësimdhënie dhe kurse në Universitet;
2. Përpilimin e strategjisë për zhvillimin akademik të Universitetit;
3. Miratimin e Statutit të Universitetit, pas sigurimit të pëlqimit të Bordit të Universitetit;
4. Të vendosur për veprimtarinë mësimore, shkencore dhe artistike të Universitetit;
5. Të përcaktuar kriteret e pranimit të studentëve;
6. Të siguruar cilësinë dhe procedurën e dhënies së kualifikimeve;
7. Të propozuar formën dhe përmbajtjen e stemës, vulës dhe vulës së thatë;
8. Të miratuar Rregulloren mbi procedurën për shqyrtimin e masave ndaj studentëve;
9. Të shqyrtuar çështjet e mbrojtjes së të drejtave të personelit dhe të studentëve;
10. Të miratuar plan programet mësimore;
11. Të vendos për propozimet e Rektorit të Universitetit për anëtarët e komisioneve;
12. Të kryer edhe punë të tjera të caktuara me këtë Statut.

Neni 39

Senati nxjerr rregulloren e punës së tij dhe të njëjtën e miraton në seancën konstituive.

Rektori cakton procedurat për mbledhjet e Senatit dhe të komisioneve të tij.

Neni 40

Senati mund të formojë këshilla ose komisione të përkohshme për ta këshilluar atë lidhur me aspekte të ndryshme të punës së tij.

Senati ka katër komisione të përhershme të quajtura:

- Komisioni i Studimeve,
- Komisioni i Habilitimit,
- Komisioni për kontrollimin e cilësisë dhe kualitetit të studimeve dhe
- Komisioni për studentë.

Anëtarët e komisionit propozohen nga Rektori i Universitetit dhe aprovohen nga Senati.

Vendimet komisionet i marrin me shumicë votash.

REKTORI I UNIVERSITETIT

Neni 41

Rektori është përgjegjës për, mirëvajtjen e punëve në Universitet dhe menaxhimin e tij brenda politikës së vendosur nga Bordi. Ai do të ketë kompetencat e domosdoshme për ushtrimin e detyrave të tij.

Neni 42

Rektori i Universitetit ka këto detyra:

- 1.1. T'i prezantojë Bordit propozimet, rekomandimet dhe opinionet e Senatit, në veçanti lidhur me karakterin arsimor dhe misionin e Universitetit;
- 1.2. Të veprojë në emër të Universitetit dhe ta përfaqësojë atë;
- 1.3. Të organizojë, drejtojë dhe menaxhojë Universitetin;
- 1.4. Të kryesojë Senatin;
- 1.5. Të drejtojë dhe zhvillojë gjithë punën mësimore – edukuese e shkencore – artistike në Universitet për përgatitjen e specialistëve të lartë;
- 1.6. Të sigurojë shfrytëzimin efikas, ekonomik dhe të dobishëm të mjeteve të Universitetit;
- 1.7. Të organizojë konkurset e pranimeve të studentëve të rinj në Universitet dhe të udhëheqë komisionin e pranimeve;
- 1.8. Të zbatojë vendimet e Bordit;
- 1.9. Të propozojë Bordit Prorektorët;
- 1.10. Të emërojë personelin ndihmës mësimor – shkencor, administrativ dhe teknik;
- 1.11. Të nënshkruajë kontratat e personelit ndihmës mësimor – shkencor dhe kontratat për aktivizim të personelit të jashtëm mësimor – shkencor;
- 1.12. Të shpallë fituesit e konkurseve të pranimit;
- 1.13. Të kryejë të gjitha detyrat e tjera në emër të Universitetit, siç janë përcaktuar me këtë Statut dhe rregulloret e tjera në fuqi.

Neni 43

Rektori mund të formojë komisione këshillëdhënëse të përkohshme për të përgatitur punët e caktuara nga fushëveprimi i tij.

Rektorin në punë e ndihmojnë edhe tre prorektorë.

Neni 44

- 1) Rektorin e zgjedh Bordi në bazë të një konkursi publik nga radhët e profesorëve të rregullt, profesorëve të asocuar ose të profesorëve asistentë nga personeli i brendshëm apo nga personeli jashtë Universitetit të cilët mund të kontribuojnë për zhvillimin e Universitetit.
- 2) Rektori zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Në rast se kandidatët e propozuar në rrethin e parë të votimit nuk fitojnë votat e nevojshme, atëherë dy kandidatët më numrin më të madh të votave kalojnë në rrethin e dytë të votimit, ku edhe zgjidhet kandidati që merr numrin më të madh të votave.
- 3) Para zgjedhjes, kandidatët për Rektorë i prezantojnë Senatit programet e tyre për zhvillimin e Universitetit.

Neni 45

Autoriteti i Rektorit do të simbolizohet përmes gjerdanit të Rektorit.

Neni 46

Rektori dhe Prorektorët emërohen për një periudhë trevjeçare me mundësi rizgjedhjeje.

Kandidatët nga alineja 1 e këtij neni duhen të jenë individë me kualifikime relevante akademike dhe të kenë aftësi për udhëheqje.

Neni 47

1) Mandati i Rektorit mund të përfundojë para kohe në rast të:

- 1.1. Dorëheqjes;
- 1.2. Shkarkimit nga detyra;
- 1.3. Arsyeve shëndetësore;
- 1.4. Dënimit për vepër penale;
- 1.5. Vdekjes.

Neni 48

Vendimin për shkarkimin e Rektorit e merr Bordi me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit.

Iniciativën me shkrim për shkarkimin e Rektorit mund ta paraqesin së paku 1/3 e anëtarëve të Senatit.

PROREKTORËT

Neni 49

Universiteti ka këta prorektorë:

1. Prorektori për çështje mësimore dhe akademike,
2. Prorektori për çështje financiare, studentore dhe administratë,
3. Prorektori për politikën zhvillimore dhe marrëdhënie me jashtë.

Neni 50

- 1) Detyrat dhe përgjegjësitë e prorektorëve i cakton rektori në pajtim me dispozitat e këtij statuti.
- 2) Prorektorët detyrat dhe përgjegjësitë i ushtrojnë brenda fushës të cilën e drejtojnë e në harmoni me udhëzimet e rektorit dhe dispozitat e Statutit.
- 3) Prorektorët për punën e tyre i përgjigjen Rektorit.

Neni 51

- 1) Mandati i prorektorëve mund të përfundojë edhe para kohe si në rastet e mëposhtme:
 - 1.1. Dorëheqjes,
 - 1.2. Shkarkimit,
 - 1.3. Arsyeve shëndetësore,
 - 1.4. Dënimit për vepër penale,
 - 1.5. Vdekje.
- 2) Mandati i prorektorit përfundon edhe me përfundimin e mandatit të rektorit, përveç nëse Bordi vendos ndryshe.
- 3) Procedura për shkarkimin e Prorektorit është e ngjashme me atë të shkarkimit të Rektorit.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I UNIVERSITETIT

Neni 52

Sekretari është zyrtari më i lartë juridik dhe administrativ i Universitetit; për punën e tij, ai i përgjigjet drejtpërdrejt Rektorit të Universitetit. Kujdeset për administrimin efikas, juridik, dhe ekonomik në të gjitha nivelet e Universitetit. Zgjidhet nga Bordi me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, sipas propozimit të Rektorit e në bazë të konkursit publik.

Kandidatët që konkurrojnë për postin e Sekretarit të Universitetit duhet të kenë diplomë universitare dhe përvojë pune në punët e ngjashme.

Neni 53

Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit janë:

1. Është zyrtari më i lartë i administratës;
2. Është zyrtar përgjegjës për punën juridike dhe administrative të Universitetit;
3. Është përgjegjës për mbajtjen e evidencës së rregullt për kandidatët që paraqiten për praninë; studentët e regjistruar në të gjitha fakultetet e Universitetit; të diplomuarit; personelin me kontratë; pronën; ndërmarrjen e masave për pranimin e punës së shërbimeve të administratës së Universitetit; dhënien e mendimeve dhe përgatitjen e akteve të përgjithshme të Universitetit dhe të fakulteteve;
4. Kryen edhe punë të tjera të parapara me këtë Statut dhe ligj.

4. STAFI AKADEMIK DHE JOAKADEMIK

Neni 54

Të gjitha vendet e punës në Universitet bazohen mbi kontratat me normë të plotë dhe mbi ato me gjysmë normë.

1. Staf i akademik

Neni 55

Në Universitet veprimtarinë mësimore, shkencore, artistike dhe profesionale e zhvillon personeli akademik, kualifikimi i të cilëve përcaktohet me zgjedhje në tituj shkencor – mësimorë dhe në tituj të bashkëpunëtorëve.

1.1. Titujt dhe procedura e zgjedhjes së personelit akademik

Neni 56

Personeli akademik në përputhshmëri me sistemin e Bolonjës përbëhet nga:

1. Profesorët e rregullt,
2. Profesorët e asocuar,
3. Profesorët asistentë,
4. Asistentët,
5. Asistentët e rinj,
6. Lektorët.

Thirrjet akademike rregullohen me rregullore të veçantë.

Neni 57

1. Zgjedhja e personelit akademik bëhet në mënyrë transparente në bazë të konkursit publik.
2. Në bazë të propozimeve të fakulteteve, Bordi shpall konkursin për zgjedhje të personelit akademik rregullisht dy herë në vit; në muajin shkurt dhe në muajin shtator. Në rast nevoje, Bordi mund të shpallë edhe më shumë konkurse gjatë vitit.
3. Konkursi zgjat 15 ditë.

Neni 58

1. Pas mbylljes së konkursit, Senati formon Komisionin e Habilitimit prej së paku tre anëtarësh për propozimin për zgjedhje në një titull të caktuar;

2. Askush nuk mund të jetë anëtarë i komisionit nëse është bashkëshort, partner ose anëtarë i familjes së ngushtë të kandidatit që duhet të zgjidhet;
3. Senati përcakton propozimin për një nga kandidatët i cili plotëson më së miri kushtet për zgjedhje;
4. Propozimi nga paragrafi 3 i këtij neni, kur bëhet fjalë për zgjedhjen e profesorëve të rregullt, profesorëve të asocuar dhe profesorëve asistentë, i dërgohet Bordit, i cili bën zgjedhjen, ndërsa Rektori lidh kontratën e punës për periudhën për të cilën janë zgjedhur në bazë të dispozitave ligjore;
5. Zgjedhjen e bashkëpunëtorëve e bën Senati, ndërsa kontratën e punës e lidh Rektori në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për periudhën për të cilën është zgjedhur.

Neni 59

Kushtet për zgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik janë kualifikimet përkatëse dhe përvoja relevante për vendin e punës.

Neni 60

Zgjedhja në titullin shkencor – mësitor profesor i rregullt, profesor i asocuar dhe profesor asistent bëhet në kohëzgjatje prej tri/katër vitesh. Ai mund të përsëritet me rekomandimin e Senatit.

1.2. Lidhja dhe shkëputja e kontratës me personelin akademik

Neni 61

Personeli akademik konsiderohet i zënë në punë në Universitet, pasi të jetë kryer procedura e zgjedhjes, me nënshkrimin e kontratës së punës.

Neni 62

Kontrata e punës me personelin akademik mund të ndërpritet para kohe në rast:

1. Dënimi për vepër penale me të cilën diskreditohet Universiteti sipas procedurës së përcaktuar me rregullore të veçantë të Universitetit;
2. Shkeljeje të rëndë të kodit të etikës së personelit akademik, në bazë të procedurës së parashikuar me atë kod;
3. Paaftësie për të ushtruar detyrën për shkaqe fizike ose mentale, të dëshmuar më raport të mjekut;
4. Cenimit të rendit, autoritetit dhe dinjitetit të Universitetit; gjë që vërtetohet në mbështetje të Rregullores së veçantë;
5. Korruptimi, gjë që vërtetohet sipas procedurës së parashikuar me Rregullore.

1.3. Procedura disiplinore

Neni 63

Puna, veprimtaria dhe sjelljet e personelit akademik të Universitetit duhet të jenë konform, parimeve morale dhe etike, parimeve të së vërtetës shkencore dhe artistike dhe ta mbrojnë autoritetin e Universitetit në mënyrën e paraparë me etikën e personelit akademik.

Neni 64

Cenimi i rregullave të sjelljes dhe moskryerja e detyrimeve të përcaktuara me këtë Statut, me kodin e etikës dhe me aktet e tjera të Universitetit nga personeli akademik dhe joakademik, tërheq përgjegjësinë disiplinore.

Procedura disiplinore përcaktohet me Rregulloren mbi Procedurën Disiplinore të Universitetit, të cilën e nxjerr Bordi në pajtim me ligjin, në pajtim me këtë Statut, me kodin e etikës dhe akteve të tjera të Universitetit.

2. Stafi joakademik

Neni 65

1) Në personelin joakademik të Universitetit bëjnë pjesë personat që angazhohen në:

- 1.1. Detyra udhëheqëse dhe profesionale;
- 1.2. Administratë;
- 1.3. Punë teknike.

Përgjegjësitë dhe kualifikimet e veçanta për çdo post do të përcaktohen me përshkrimin e punës të caktuar nga Rektori me sugjerimin e Sekretarit të Përgjithshëm, ose nga përgjegjësi i njësisë akademike apo organizative.

5. STUDENTËT DHE ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 66

Student i Universitetit është personi i regjistruar në Universitet, i cili i plotëson detyrimet e veta akademike dhe financiare në pajtim me ligjin dhe aktet e përgjithshme të Universitetit.

Neni 67

Studimet mund të vijohen me shkëputje nga puna dhe pa shkëputje nga puna, ashtu siç parashihet në Statutin e Universitetit dhe me Rregulloren e tij.

- Regjistrimi në studime

Neni 68

Pranimi në studime në Universitet bëhet në bazë të konkursit publik dhe në bazë të procedurës përzgjedhëse dhe kriterëve të vlerësimit që i cakton Senati.

Neni 69

Vendimin për shpalljen e konkursit e merr Bordi i Universitetit me propozimin e njësisë akademike të Universitetit.

Neni 70

- 1) Studenti fiton të drejtën e regjistrimit në vitin vijues të studimeve në qoftë se i kryen të gjitha detyrimet e përcaktuara me plan – programin mësimor, Rregulloren mbi studimet dhe aktet e tjera të përgjithshme.
- 2) Studenti mund të regjistrojë sërish të njëjtin vit të studimeve sipas kushteve të përcaktuara më Rregulloren mbi studimet, duke i përmbushur detyrimet financiare ndaj Universitetit.

Neni 71

Studenti duhet t' i mbarojë studimet themelore akademike brenda një periudhe që nuk tejkalon dyfishin e periudhës normale të paraparë për studimet të cilat i ka regjistruar, me përjashtim të rasteve të veçanta për të cilat vendos Senati.

Neni 72

Studenti humb statusin e studentit:

1. Kur përfundon studimet;
2. Kur ç'regjistrohet;
3. Kur nuk regjistrohet në vitin vijues ose në të njëjtin vit të studimeve;
4. Me vendim nga procedura disiplinore;
5. Kur nuk i kryen studimet në afatin e përcaktuar në pajtim me nenin paraprak të këtij Statuti;
6. Më vdekjen e studentit;
7. Në raste të tjera të përcaktuara me Rregulloren e Universitetit.

- Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Neni 73

- 1) Studentët të cilët janë pranuar në Universitet kanë të drejtë:

- 1.1. Të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminarët dhe aktivitete tjera të organizuara nga lëndët e tyre sipas pozitës së tyre;
- 1.2. Të përdorin objektet e bibliotekës, internetin si dhe shërbimet e tjera për studentë;
- 1.3. Të marrin pjesë në zgjedhje për pozitën e studentëve në organet e Universitetit;
- 1.4. Të organizohen në organizata studentore jopolitike duke iu përmbajtur përcaktimit të ligjeve dhe akteve të Universitetit AAB (Statutit dhe rregulloreve);
- 1.5. Në fund të vitit akademik të marrin certifikatën e notave pa pagesë;
- 1.6. Më përfundimin e rregullt të studimeve të pajisen me diploma përkatëse

Neni 74

1) Detyrat e studentëve janë:

- 1.1. Të zbatojnë rregulloret e miratuara nga Universiteti;
- 1.2. Të kenë konsideratë të mjaftueshme ndaj personelit dhe studentëve të tjerë;
- 1.3. Të kenë konsideratë dhe kujdes të plotë për studimet e tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
- 1.4. Të sillen mirë brenda dhe jashtë objekteve të Universitetit në mënyrë që të mos e diskreditojnë Universitetin;

Neni 75

Studentët kanë të drejtë të ankohen për cilësinë e ligjërimit ose për atë të kushteve të Universitetit. Ankesat fillimisht do t'i dorëzohen dekanit ose personit përgjegjës me kërkesë të mëtutjeshme deri te Rektori – Senati.

Neni 76

Këshilli i fakultetit mund t'i çregjistrojë studentët që dështojnë të bëjnë progres adekuat në studimet e tyre në bazë të një kërkesë që mund t' i bëhet Senatit ose Komisionit të emëruar nga Senati, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Rregulloret që elaborojnë këtë procedurë do të nxirren nga Bordi me propozimin e Senatit.

Neni 77

- 1) Senati mund t' i largojë nga Universiteti përkohësisht ose përgjithmonë studentët të cilët nuk sillen mirë. Studentët të cilët akuzohen për sjellje joadekuate do të merren në pyetje nga Komisioni Disiplinor i cili do të këshillojë Senatin.
- 2) Suspendimi para marrjes në pyetje mund të autorizohet nga Rektori. Studentët e larguar, përkohësisht ose përgjithmonë nga ana e Senatit, mund t' i drejtohen me ankesë Bordit i cili konfirmon ose ndryshon vendimin e Senatit.

- 3) Masa më e lehtë disiplinore është vërejtja publike, kurse masa më e ashpër është përjashtimi i përhershëm nga Universiteti.
- 4) Rregullorja e cila elaboron këto procedura nxirret nga Bordi në bazë të propozimit nga Senati.

Neni 78

- 1) Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore në të cilat mund të aderojnë të gjithë studentët.
- 2) Interesat e studentëve do të përfaqësohen në kuadër të Universitetit me këto organe:
 - 1.1. Parlamenti i studentëve të Universitetit;
 - 1.2. Këshilli i studentëve të njësisë akademike.
- 3) Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për parlamentin e studentëve dhe këshillat e studentëve të njësisë akademike në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy vjet.
 - Llojet e studimeve dhe kushtet për regjistrim

Neni 79

Studimet në Universitet përcaktohen në kuadër të programeve të studimeve. Përmbajtja e programeve të studimeve për mësimdhënie përcaktohet me rregulloret e përgatitura nga këshilli akademik i fakultetit përkatës, dhe aprovet nga Senati.

Neni 80

Universiteti ofron këto lloje të studimeve themelore akademike dhe pasdiplomike:

1. Studimet themelore
 - a) Studimet bachelor
2. Studimet pasdiplomike:
 - a) Studimet master
 - b) Studimet e doktoratës

Neni 81

Studimet themelore zgjasin së paku tre vjet dhe me këtë studentët fitojnë përgatitje të lartë akademike si dhe marrin diplomën Bachelor nga fusha përkatëse e studimeve.

Neni 82

Studimet pasdiplomike zgjasin së paku dy vjet pas përfundimit të studimeve themelore dhe me këtë studentët fitojnë përgatitjen e lartë akademike si dhe marrin titullin akademik Master nga fusha përkatëse e studimeve.

Neni 83

- 1) Studimet e doktoratës janë studimet më të larta akademike që ofron Universiteti;
- 2) Në studimet e doktoratës mund të regjistrohen kandidatët që kanë përfunduar më sukses shkallën master të lëmit përkatës;
- 3) Studimet e doktoratës zgjasin zakonisht 3 – 4 vjet. Kusht për fitimin e titullit të doktoratës është përfundimi me sukses i provimeve të doktoratës dhe mbrojtja me sukses e tezës së doktoratës;

Neni 84

Kushtet për praninë në studimet themelore në Universitet janë:

1. Përfundimi me sukses i shkollës së mesme në Kosovë i vërtetuar me diplomë;
2. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme më së paku 12 vjet të shkollimit i vërtetuar me diplomë përkatëse;
3. Autorizimi i veçantë i lëshuar nga ana e Ministrisë.

Çdo student duhet të kalojë me sukses provimin pranues për regjistrim në vitin e parë të studimeve.

Neni 85

Studimet pasdiplomike për master mund t'i regjistrojë kandidati i cili ka përfunduar studimet themelore përkatëse universitare.

- Planet dhe programet mësimore

Neni 86

Me planë – programin mësimorë përcaktohet hollësisht se çka duhet të plotësohet për çdo lloj të studimeve.

Neni 87

Plan – programin mësimorë e miraton Senati me propozim të fakulteteve përkatëse.

Neni 88

Plan – programi mësimor përmban lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore, të cilat rregullohen më hollësisht me Rregulloren e Universitetit.

Neni 89

- 1) Me rastin e përcaktimit të planit mësimor, Universiteti duhet të kujdeset posaçërisht që studimi të jetë:
 - 1.1. Bashkëkohor dhe t'i përshtatet mundësive dhe interesave të studentëve;
 - 1.2. I krahasueshëm me institucionet e tjera të larta arsimore në shtetet e zhvilluara;
 - 1.3. Në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe me ato të përcaktuara nga Ministria.
- 2) Çdo mësimdhënës është i detyruar që në fillim të vitit shkollor t'u dorëzojë Universitetit, fakultetit dhe studentëve programin mësimor të lëndës që ligjëron.

Neni 90

Fakultetet e Universitetit në fillim të çdo viti akademik e bëjnë listën e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve për tërë vitin akademik sipas planit mësimor.

Neni 91

Viti akademik fillon me 1 tetor të vitit vijues dhe përfundon më 30 shtator të vitit të ardhshëm.

Mësimi organizohet në semestra (semestri dimëror prej 1.10 – 15.01 dhe semestri veror prej 16.02 – 31.05 të vitit vijues).

- Përcaktimi i suksesit akademik

Neni 92

Studenti vlerësohet në mënyrë periodike gjatë tërë procesit të mësimin, ndërsa nota definitive përcaktohet në provimin përfundimtar nga ana e mësimdhënësit të lëndës.

1. Provimet jepen nga të gjitha lëndët të cilat studenti i ka regjistruar në bazë të materies së përcaktuar me programin mësimor.
2. Provimit mund t'i nënshtrohet studenti i cili i kryen të gjithë obligimet e përcaktuara me këtë Statut dhe me aktet e tjera të Universitetit.
3. Suksesi i arritur në provim është publik.

Neni 93

Provimi është publikë dhe studenti ka të drejtë të kërkojë që publiku të jetë i pranishëm gjatë provimit.

Neni 94

Suksesi i studentit shprehet me nota prej 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë).
Nota 5 (pesë) shpreh suksesin e pamjaftueshëm dhe për të mbahet evidencë e posaçme.

Neni 95

1) Afatet e provimeve janë:

- 1.1. Afatet e rregullta: afati i janarit, afati qershorit dhe afati i shtatorit. Këto afate janë fikse dhe publikohen.
- 1.2. Afati i jashtëzakonshëm është afati i prillit, ndërsa për absolventët është edhe afati i nëntorit.

Neni 96

Orari i provimeve shpallet në fillim të çdo viti për të gjitha afatet, me hollësisht rregullohet me Rregulloren e Universitetit

6. TITUJT AKADEMIKË DHE DIPLOMAT

Neni 97

Sipas kushteve për akreditim të parapara me ligj, Universiteti jep këta tituj akademikë dhe diploma:

- 1- Diplomë për studime themelore Bachelor (BA);
- 2- Diplomë për studime të magjistraturës – Master (MA);
- 3- Diplomë për studime të doktoratës (Dr.sc.)

Universiteti mund të lëshojë diploma në bashkëpunim me Universitetet partnere.

Neni 98

Vlerësimi për studime themelore Bachelor do të bëhet sipas sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) në tërë Universitetin. Studentëve do t'u mundësohet bartja e kredive nga Universiteti në institucionet e tjera brenda vendit dhe jashtë vendit.

Neni 99

Studentëve do t'u njihen kreditë e fituara edhe në kurset e akredituara në ministritë përkatëse.

Neni 100

Diploma Bachelor jepet pas përfundimit të studimeve themelore akademike.

Neni 101

Diploma e magjistrisë (master) jepet pas përfundimit të suksesshëm të studimeve përkatëse pasuniversitare dhe mbrojtjes publike të punimit të magjistraturës.

Neni 102

Vlerësimi në studimet pasuniversitare të magjistraturës bëhet sipas Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS). Studentëve do t'u mundësohet bartja e kredive nga Universiteti në institucionet e tjera të arsimit të lartë brenda vendit dhe jashtë tij.

Neni 103

Numri i kredive dhe mënyra e vlerësimit të aftësisë së studentëve në studimet themelore dhe pasdiplomike përcaktohen me Rregulloren e Universitetit.

Neni 104

1. Të gjitha programet e studimeve themelore të Universitetit përmbillen me punimin e diplomës për bachelor ose me provimin para komisionit në pajtim me programet e tyre të studimeve.
2. Punimi i diplomës për bachelor elaborohet individualisht nga studenti duke vërtetuar që aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore.
3. Punimi i diplomës për bachelor mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre studentë (grup hulumtues) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.

Neni 105

Të gjitha programet e studimeve pasdiplomike të Universitetit përmbillen me punimin e tezës për master në pajtim me programet e studimeve.

Procedura për paraqitje, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për master përcaktohet nga Senati.

Neni 106

- 1) Disertacioni i doktoratës është një punim shkencor i cili shtjellon në mënyrë origjinale dhe unike një apo më shumë tema të shkencës përkatëse.
- 2) Procedura për paraqitjen, elaborimin, mbrojtjen dhe vlerësimin e disertacionit të doktoratës përcaktohet nga Senati.
- 3) Pas përfundimit të suksesshëm të disertacionit të doktoratës, kandidati fiton titullin akademik doktor i shkencave (Dr.sc.) ose ekuivalentin, siç definohet në rregulloret e veçanta të nxjerra nga Senati.

Neni 107

Universiteti organizon promovimin e të diplomuarve që fitojnë titullin master dhe studimet e doktoratës për çdo gjashtë muaj.

Mënyra, kushtet dhe procedurat e promovimit përcaktohen me Rregulloren e Universitetit.

7. FINANCIMI

Neni 108

Në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, Universiteti siguron mjete financiare nga këto burime:

1. Nga tarifat e shkollimit, tarifat administrative dhe pagesat e tjera që i bëjnë studentët;
2. Nga pagesat për shërbimet komerciale dhe shërbimet e tjera;
3. Nga fondet e Ministrisë të buxhetit të Kosovës për mësimdhënie dhe kërkime shkencore – artistike me interes të përgjithshëm;
4. Nga donacionet, dhuratat dhe ndihmat;
5. Nga shfrytëzimi i pronësisë intelektuale të Universitetit;
6. Nga kontratat me organizatat kombëtare, ndërkombëtare, publike ose private në fushën e mësimdhënies, kërkimeve shkencore, artistike;
7. Nga çdo lloj burimi tjetër i lejuar nga ligjet në fuqi të Kosovës.

Neni 109

Universiteti ka llogarinë rrjedhëse.

Mjetet e realizuara nga neni paraparak i këtij Statuti derdhen në llogarinë rrjedhëse të Universitetit.

Neni 110

Metodologjia e financimit, kushtet e tij dhe kontrolli financiar përcaktohen më detajisht me Rregulloren e Universitetit.

8. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 111

Në pajtim me ligjin dhe me këtë Statut duhet të hartohet Rregullorja e Universitetit dhe aktet e tjera të përgjithshme të organeve të tij.

Neni 112

Statuti i Universitetit mund të ndryshohet sipas procedurës së miratimit të tij.

Statuti është miratuar nga Senati i Universitetit.

Rektori i Universitetit
Urosh Lipuscek, PhD

Prishtinë
25.09.2008